

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Thaçi dhe Veseli e morën me pranga"/ Gjykata e Hagës për zhdukjen e Behajdin Allaqit 28 vite më parë: Jemi të bindur se ai u vra
ADRESA	https://piranjat.al/kosova/thaci-dhe-veseli-e-moren-me-pranga-gjykata-e-hages-per-zhdukjen-e-behajdi-i104461
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:45:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:29:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b54ef07da4066d7ece35f2728574f448848fae1bd8ea8193d0d448477c47157d
TEKSTI	9cd34013b97117f1d80192165dd97a249537d98e0d5624ff62ada05afc170586
PAMJA	426798884bf87aef2c101dd887b5f5ab9b9c7cd5043f1beee90572de959d162

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ce75fb8b3c260c0114c1556de32cd25766e5ae4a6144524d0e4157a576fb4e02
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9235283646fceb4f2e036f737b53ac1b0d6441cb2e31166fde86e3118480b863
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/ce75fb8b3c260c0114c1556de32cd25766e5ae4a6144524d0e4157a576fb4e02

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: ne ruge edhe Olta Xhachën: O

Taulant Ballën, protestuesit

që dënoi me 81

trupin gjykes në rastin

te Hagës: Nië ditë

Hagës ndaj katër drejtuesve të UÇK-së

aktgjykimit ndaj liderëve të

nga Dhomat e Specializuara

ne Maliq, banorët kundër

për shkrimin e bashkisë së tyre dhe

vende flamur komb

KOSOVA

“Thaçi dhe Veseli e morën me pranga”/ Gjykata e Hagës për zhdukjen e Behajdin Allaqi 28 vite më parë: Jemi të bindur se ai u vra

Prijanaj Përditësimi i fundit 16 Shtator 2026, 15:29



Një prej rasteve më të përfolura dhe të pazbardhura të luftës në Kosovë, zhdukja dhe vrasja e veprimtarit Behajdin Allaqi, mori më 16 shtator 2026 një përgjigje gjyqësore nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë. Gjatë shpalljes së aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykes bëri një konstatim të drejtpërdrejtë për rolin e Thaçit në rastin Allaqi.

“Trupi Gjykes konstatoi se Hashim Thaçi mori pjesë personalisht në krime, duke përfshirë arrestimin, ndalimin dhe marrjen në pyetje të 13 parlamentarëve, si dhe arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e Behajdin Allaqi”, thuhet në përmbledhjen e aktgjykimit.

Ky formulim ka rëndësi për një arsye konkrete. Gjykata nuk e lidh Thaçin me rastin Allaqi vetëm përmes përgjegjësisë për veprimet e personave të tjerë, por konstaton pjesëmarrjen e tij personale në krimet ndaj tij. Trupi Gjykes e dha këtë konstatim në aktgjykimin e shkallës së parë. Gjykata e dënoi Thaçin me 25 vjet burgim, ndërsa mbrojtja ka të drejtën ta kundërshtojë vendimin në apel.

Kush ishte Behajdin Allaqi?

Behajdin Allaqi, i lindur më 7 prill 1963 në Prizren, ishte veprimtar politik dhe pjesë e organizimeve politike shqiptare që prej viteve '80. Ai mori pjesë në demonstratat e vitit 1981 dhe më pas në veprimtarinë ilegale që synonte avancimin e statusit politik të Kosovës. Gjatë viteve '90 vazhdoi aktivitetin në strukturat e lëvizjes kombëtare dhe më vonë iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Allaqi u zhduk më 11 qershor 1998. Trupi i tij nuk është gjetur. Për më shumë se 28 vjet, familjarët, bashkëveprimtarët dhe figura të ndryshme publike kërquan sqarimin e rrethanave të arrestimit, zhdukjes dhe vrasjes së tij. Përgjatë kësaj kohe qarkulluan akuza dhe dëshmi të ndryshme, por mungonte një konstatim gjyqësor që përcaktonte përgjegjësi individuale.

Aktgjykimi i 16 shtatorit ndryshon pikërisht këtë pjesë të historisë së çështjes.

Çfarë konstatoi Gjykata për Thaçin?

Sipas përmbledhjes së aktgjykimit, Gjykata konstatoi se Thaçi, si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm dhe drejtues i Drejtorisë Politike të UÇK-së, kishte rol në formulimin dhe zbatimin e një qëllimi të përbashkët kundër personave të perceptuar si kundërshtarë të UÇK-së.

Sipas konstatimeve të Trupit Gjykes, ky qëllim përfshinte identifikimin e personave të perceptuar si kundërshtarë, arrestimin dhe ndalimin e tyre, krijimin dhe funksionimin e objekteve të ndalimit, keqtrajtimit dhe në raste të caktuara vrasjen e të ndaluarve, si dhe përdorimin e deklaratave publike kundër personave të cilësuar si “bashkëpunëtorë” ose kundërshtarë.

Por në rastin e Behajdin Allaqi, Gjykata shkoi më tej. Trupi Gjykes konstatoi se Thaçi mori pjesë personalisht në katër faza të krimit ndaj Allaqi: arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen. Ky është edhe elementi që e veçon çështjen Allaqi nga përgjegjësia më e gjerë që Gjykata shqyrtoi ndaj ish-drejtimesve të UÇK-së.

Po Veseli, Selimi dhe Krasniqi?

Trupi Gjykes shpalli përgjegjësi edhe Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin për kontributin e tyre në qëllimin e përbashkët kriminal kundër personave të perceptuar si kundërshtarë të UÇK-së.

Në përmbledhjen publike të aktgjykimit nuk thuhet se Veseli, Selimi dhe Krasniqi morën pjesë personalisht në arrestimin apo vrasjen e Behajdin Allaqi. Për këtë arsye, vendimi i Gjykatës nuk i identifikon të katër ish-drejtimesit e UÇK-së si ekzekutorë apo bashkautorë të drejtpërdrejtë të vrasjes së Allaqi.

Konstatimi individual i bërë publik për arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e tij lidhet shprehimisht me Hashim Thaçin.

Nga akuzat e 28 viteve te një konstatim gjyqësor

Emri i Behajdin Allaqit është përmendur për vite me radhë në dëshmi, deklarata publike dhe përplasje politike për ngjarjet e vitit 1998. Në këtë histori janë ngritur edhe pretendime për përplasjet e tij me drejtues të atëhershëm politikë të UÇK-së. Por pretendimet publike dhe akuzat politike nuk janë aktgjykime.

Për këtë arsye, aktgjykimi i 16 shtatorit 2026 shënon një pikë konkrete në çështjen Allaqi: një trup gjykues ka konstatuar përgjegjësi individuale të Hashim Thaçit për arrestimin, ndalimin, transferimin dhe vrasjen e tij.

Vendimi nuk është ende i formës së prerë. Ai është aktgjykim i shkallës së parë dhe mbrojtja mund ta ankimojë.

Por pas 28 vitesh, çështja e Behajdin Allaqit nuk mbetet më vetëm te akuzat, dëshmitë dhe përplasjet politike. Që prej 16 shtatorit 2026, ajo përmban edhe një konstatim gjyqësor konkret për rolin personal të Hashim Thaçit.

Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 16 Shtator15:25

[Kush është Charles Smith, gjyqtari që dënoi me 81 vjet burgim katërsheh e UÇK-së](#)

Charles L. Smith III është gjyqtari amerikan që kryesoi trupin gjykues në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, R...

KOSOVA 16 Shtator15:18

[“A ka rrezik të vdesë në burg?”/ Milaim Zeka shpërthen në lot, tregon komentin e vajzës për dënimin e ish-krerëve të UÇK-](#)

Gazetari i njohur, Milaim Zeka, ka shpërthyer në lot gjatë lidhjes së drejtpërdrejtë me emisionin “Shqipëria Live&rdquo...

KOSOVA 16 Shtator14:58

[Jorida Tabaku reagon pas vendimit të Hagës: Një ditë e rëndë për çdo shqiptar](#)

Jorida Tabaku ka reaguar pas vendimit të Hagës ndaj katër drejtuesve të UÇK-së, duke e cilësuar ...

KOSOVA 16 Shtator14:55

[Ambasada e Kosovës në Hagë reagon pas aktgjykimit ndaj liderëve të UÇK-së](#)

Ambasada e Republikës së Kosovës në Hagë ka reaguar pas verdiktit të dhënë sot nga Dhomat e Specializuara të Koso...

KOSOVA 16 Shtator14:46

[Prekëse! Polici i Kosovës përlotet kur i vendosin flamurin kombëtar dhe të UÇK-së](#)

Pamje prekëse e tepër emocionuese vijnë nga Prishtina. Një polic i Kosovës ka qarë, kur protestuesit i vendosin pranë flam...

KOSOVA 16 Shtator14:33

[Vendimi i Hagës, reagon Albin Kurti](#)

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj katër ish-krerëve të U&...

KOSOVA 16 Shtator14:31

[“Vetëm bashkimi e shpëton kombin”, protestuesi me lot në sy: Vendimi i Speciales i padrejtë, dënon luftën çlirimtare!](#)

Një prej protestuesve të mbledhur para zyrave të EULEX-it në Fushë-Kosovë ka reaguar me lot në sy pas vendimit të Gjyk...

KOSOVA 16 Shtator14:24

[A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkruar Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë?](#)

Vendimi i sotëm i Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së ka rikthyer në Kosovë debati...

KOSOVA 16 Shtator14:05

[Haga dënoi me 81 vite burg në total 4 ish-krerët e UÇK-së, Serbia thyen heshtjen](#)

Zëvendëskryeministri dhe ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Serbisë, Ivica Dačić, tha se aktgjy...

KOSOVA 16 Shtator14:02

[Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit](#)

Gjykata Speciale e Hagës dënoi sot me 81 vite burg të katër ish liderët e UÇK-së, Hashim Thaçin (25 vite burg), Ka...

BOTA 15 Shtator

[Takimi pikant zgjat shumë dhe përfundon si mos ...](#)

Një takim seksual tepër i gjatë, një vjedhje parash, një debat midis një eskorte dhe klientit të saj, dhe në fund një...

AKTUALITET 16 Shtator

[Pagat ndryshojnë strukturë/ Gati gjysma e të pu...](#)

Një e katërta e të punësuarve që derdhin kontributin e parë me pagë deri në 50 mijë lekë në muaj, ndë...

KOSOVA 16 Shtator

[Dënohet me 25 vite burg Hashim Thaçi](#)


Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është shpallur fajtor për krime lufte dhe është dënuar me 25 vjet burgim nga...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.